

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISËME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

BALPRO sh.p.k

Sot ,më datë **17.06.2024** në Tiranë themelohet shoqëria BALPRO shpk ,me seli në rrugën “Rruga Taulantët” Kodër-Kamëz , Godina e Universitetit Qiriazhi, Kati 1, Nr. 13, 1029, nga ortakët si më poshtë:

1. Znj. Anxhela Uldedaj shtetase Shqipëtare, lindur më 25.08.1995 me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Znj. Enxhi Uldedaj , shtetase Shqipëtare, lindur më 05.06.1994 me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet **BALPROshpk** . (Këtu e më poshtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë në “Rruga Taulantët”, Godina e Uniersitetit Qiriazhi, Kati 1, Nr. 13, Kodër Kamëz , 1029

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Operim në shërbime si bar dhe restorant e ndërthurur si një strukturë trajnuese në sektor të ndryshëm të fushës së turizmit, menaxhimit, komunikimit publik, aftësive të forta e të buta. Gjitashtu dhe ofrim shërbimi ndërmjetësim në tregun e punës.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

5.1Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 lekë dhe është i ndare në 2 kuota.

5.2Znj. Anxhela Uldedaj zotëron 1 kuote, 50% të kapitalit të shoqërisë në vlerë 500lekë.

5.3Znj Enxhi Uldedaj zotëron 1 kuote, 50% të kapitalit të shoqërisë në vlerë 500 lekë.

5.4Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues.Kuota ePjesmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme.Kapitali është tërësisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

6.1Ortaku që ka ndërmend të shesi kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet më parë të njoftojë ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë.Këto të drejta ortaku duhet ta ushtrojë Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

6.2Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afruara ortaku tjetër të shoqërisë.

NENI 7

7.2Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 8

8.1Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

NENI 9

9.1 Heqja dorë e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij .

NENI 10

10.1 Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

10.2 Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj .

KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11

Kompetencat e ortakut

11.1 Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Kane të drejtë të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesve në këtë aktivitet.

11.2 Kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.

11.3 Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.

11.4 Ortakët në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë ortak edhe në shoqëri të tjera.

11.5 Ortakët rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

NENI 12

12.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj *znj. Enxhi Uldedaj*.

NENI 13

Administrimi i shoqërisë

13.1 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakëve.

13.2 Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjyqesore.

13.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per deme te kryera gjate administrimit.Ortaku ka te drejte te ngrej padi ndaj administratorit.

13.4 Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te ortakut, kan të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

13.5 Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , te cilet qendrojne ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vjetesh

13.6. Çdo administrator do te ketë te drejte për rimbussimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqërisë .

13.7 Kur administrator i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financiar te kompanise atehere ortakët vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij ne fund te vitit financiar .

NENI 14

Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta.

- Te mirë administroje pasurine e shoqerise
- Te lidh marëveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortakët.
- Te zbatoje rregullat e brendeshme te shoqerise
- Te shperbleje demet qe l vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marveshjes se bere midis tij dhe ortakëve.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quant e dobishme per shoqerine
- Te mirtaoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit per miratimin perfundimntar nga ortakët
- Te behen prpozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne aportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin e personelin

- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Ti propozoje ortakeve per krijimin e enjesive strukturave te ndryhsmë si filial, dege e e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- Te përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqes propozimet për miratim para ortakeve .
- Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje çdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 15 EKSPERTI KONTABEL

15.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administrator

15.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi per mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit te shoqërisë

15.3 Ato përgjigjen për demet qe i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

15.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund te shkarkohet sipas mënyrës se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi .

15.5 Nuk mund te ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat qe jane ne gjini e krushqi deri ne shkallen e katert. Po ashtu nuk mund te kryeje kete detyre pergjegjsat e syrave, filialeve e agjensive.

KREU III MARDHENIET E PUNES

NENI 16

16.1 Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çeshtjet që kjo kontratë nuk l parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqipëtar në fuqi.

NENI 17

17.1 Për çdo mos marrëveshje qe mund te lind midis palëve dhe qe nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 18

Sekreti i punës

18.1 Te gjithë të punësuarit ne shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV
VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 19

Viti financiar

19.1 Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Përfundimisht Viti I pare financiar përfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor te te nje viti.

NENI 20

Inventari dhe llogarite vjetore.

20.1 Shoqëria do te mbaje një kontabilitet te rregullt te pasurisë dhe te veprimtarisë se saj ne pajtim me kërkesat ligjore
Ne mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë ne ketë date dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

NENI 21

Raportet vjetore

21.1 Ne mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.
21.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.
21.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar(nëse është emëruar)miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 22

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.

22.1 Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit te mëparshëm, hiqet men je ane një shume e barabarte me 5 %(pese perqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezerve te quajtur “rezerve e domosdoshme “.
22.2 Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo,rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10% e kapitalit.
22.3 Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçantë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime te tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes se fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V
MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 23

23.1 Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjate dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 24

24.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjate likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

24.2 Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakëve.

24.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 25

25.1 Ortakët vendosin mbi rregulshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

25.2 Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 26

26.1 Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 27

Dispozitat e fundit

27.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

27.2 Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

27.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 28

Gjykata kompetente.

28.1 Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe intepretimim e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 29


Hyrja në fuqi

29.1 Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët.

ORTAKËT THEMELUES TE SHOQERISE

“ BAL PRO “ sh.p.k.

Znj. Anxhela Uldedaj

Anxhela Uldedaj


Znj. Enxhi Uldedaj

Enxhi Uldedaj
